



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 8 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Huper

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën ("Aktakuza e Konfirmuar") kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit ("z. Thaçi", "z. Veseli", "z. Selimi", dhe "z. Krasniqi", përkatësisht, dhe bashkërisht të quajtur "të akuzuarit").²

2. Më 30 tetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi aktakuzën e konfirmuar,³ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Konfirmimit"), 26 tetor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00034/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 30 dhjetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Një version i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar të korrigjuar, me korrigjimin e disa gabimeve me shkrim, u dorëzua me 4 nëntor 2020, F00045/A03, publik.

⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(c)-(d).

3. Më 4 dhe 5 nëntor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,⁵ z. Krasniqi, z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi u arrestuan⁶ dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁷

4. Midis 9 dhe 11 nëntorit 2020, u mbajtën seancat e paraqitjeve të para për z. Krasniqi,⁸ z. Thaçi,⁹ z. Veseli,¹⁰ dhe z. Selimi.¹¹

5. Më 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi datën e konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes [përmes një urdhri], të cilit i bashkëlidhi rendin e ditës së konferencës ("Rendi i Ditës i Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes") dhe kërkoi nga palët parashtrime përpara seancës.¹²

⁵ KSC-BC-2020-06, F00027/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, publik, me Shtojcat 1-8, publike. Versionet e korrigjuara të Shtojcave 7 dhe 8 u dorëzuan më 28 tetor 2020, *shih* F00027/A07/COR/RED dhe F00027/A08/COR/RED, përkatësisht.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Jakup Krasniqit sipas Rregullës 55(4)*, 4 nëntor 2020, publik; F00049, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Rexhep Selimit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00050, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00051, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit të Hashim Thaçit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Jakup Krasniqit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 4 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publik; F00053, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publik, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00054, *Njoftimi i pranimit të Kadri Veselit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00055, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit të Rexhep Selimit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe për Çështje lidhur me të*, 5 nëntor 2020, publik, para. 21(a). *Shih gjithashtu* Transkript, 9 nëntor 2020, publik.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00057, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështjeve lidhur me të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih gjithashtu* Transkript, 9 nëntor 2020, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00060, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështjeve të lidhura me të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih gjithashtu* Transkript, 10 nëntor 2020, publik.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00061, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështjeve të lidhura me të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih gjithashtu* Transkript, 11 nëntor 2020, publik.

¹² KSC-BC-2020-06, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër i Caktimit të Datës për Mbajtjen e Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 11 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike. Palët dorëzuan parashtrimet e tyre siç u kërkua, *shih* KSC-BC-2020-06, F00076,

6. Më 18 nëntor 2020, u zhvillua konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes.¹³ Në fund të seancës, të katër ekipet e Mbrojtjes iu referuan mesit të dhjetorit si datë e mundshme për konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes.¹⁴
7. Më 23 nëntor 2020, ZPS-ja paraqiti parashtrime shtesë me shkrim rreth datës së propozuar për fillimin e gjykimit.¹⁵
8. Gjithashtu, më 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështjeve lidhur me to” (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave”), ku përcaktohen parimet që rregullojnë nxjerrjen e provave midis palëve, një kalendar për nxjerrjen e provave deri në korrik 2021, dhe sistemin e redaktimit të zbatueshëm në çështjen aktuale.¹⁶
9. Më 27 nëntor 2020, Mbrojtja e z. Selimi njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se nuk kishte mundur të arrinte një marrëveshje me ZPS-në në lidhje me përmbajtjen dhe afatin për paraqitjen e tabelës së nxjerrjes së materialit sipas rregullës 109(c) të Rregullores.¹⁷ Po atë ditë, ZPS-ja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake: (i) se ishte arritur vetëm një marrëveshje e pjesshme me Mbrojtjen lidhur me afatin dhe kuadrin e një tablele përmbledhëse të nxjerrjes së materialit; dhe (ii) për mungesën në vijimësi

Prokurori i Specializuar, *Parashtrimet e Prokurorisë për Konferencën e parë mbi Ecurinë e Çështjes*, 13 nëntor, publik; F00082, Mbrojtja e Krasniqit, *Parashtrime të Mbrojtjes në emër të Jakup Krasniqit për Konferencën e parë mbi Ecurinë e Çështjes*, 17 nëntor 2020, publik; F00083, Mbrojtja e Selimit, *Parashtrimet e Mbrojtjes për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes*, 17 nëntor 2020, publik; F00085, Mbrojtja e Thaçit, *Parashtrimet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes*, 17 nëntor 2020, publik; F00087, Mbrojtja e Veselit, *Parashtrimet në Emër të Kadri Veselit, Konferenca mbi Ecurinë e Çështjes – e mërkurë 18 nëntor*, 17 nëntor 2020, publik.

¹³ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 18 nëntor 2020, publik.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 18 nëntor 2020, f. 178, rreshti 22 deri në f. 179, rreshti 13, publik.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00097, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë pas Konferencës së 18 nëntorit 2020 mbi Ecurinë e Çështjes*, 23 nëntor 2020, publik.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me Të*, 23 nëntor 2020, publik, para. 99.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00106, Mbrojtja e Selimit, *Njoftimi i Mbrojtjes në lidhje me rregullën 109(C)*, 27 dhjetor 2020, publik.

të marrëveshjes midis palëve lidhur me nivelin e kategorizimit të materialit të nxjerrë në meta-të dhënat në *Legal Workflow*, që bëhet çdo herë kur duhet nxjerrë material.¹⁸

10. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores, pas konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencat vijuese mbi ecurinë e çështjes, në qoftë se e gjykon të nevojshme për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësve të viktimave, për të garantuar përgatitje të shpejta për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes, dhe që palëve, e kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen.

11. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në posedim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizimet rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e garancive mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i dorëzon Mbrojtjes një njoftim të hollësishëm të çdo materiali dhe prove që ka në posedim.

12. Në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë: (i) dosjen e vet paraprake, e cila ndër të tjera përmban çfarëdo pranimi në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes dhe një listë të pikave të pakontestuar; (ii) listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë; dhe (iii) lisën e provave që synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdoherë që

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00108, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimet mbi Kategorizimin sipas Rregullës 109(c)*, 27 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike.

është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e këtyre provave.

13. Në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen e vet paraprake. Gjithashtu, brenda një afati të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja njofton ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike apo ligjore.

14. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit pas këshillimit me mbrojtësin, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit, me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) me praninë e mbrojtësit, me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesën e të akuzuarit, në praninë e mbrojtësit ose pjesëmarrjen nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për pjesëmarrje në konferencë mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës, i drejtohet Administratores drejtpërsëdrejti, në përputhje me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR), dhe mjaftueshëm në kohë në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, ndër të tjera edhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake.¹⁹

¹⁹ *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes, 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes, 9 nëntor 2020, publik, para. 9.*

II. DUSKUTIM

15. Duke marrë parasysh parapëlqimet e palëve të shprehura gjatë konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të mbajë konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes të enjten, 17 dhjetor 2020, në orën 11:00.

16. Gjatë seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve të japin përditësime lidhur me problemet ende të pazgjidhura që u përvijuan në rendin e ditës së konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, si dhe mbi parashtrimet me shkrim ose me gojë të bëra nga palët deri tani. Konkretisht dhe gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, do të kërkojë përditësime lidhur me sa vijon, dhe me renditjen e përcaktuar më poshtë:

(1) Nxjerrja e materialit:

- a. Nëse palët kanë hasur në ndonjë vështirësi në lidhje me nxjerrjen e materialit provues;
- b. Nëse ka pasur ndonjë përparim në arritjen e marrëveshjes midis palëve mbi nivelin e kategorizimit të materialit të nxjerrë në pajtim me rregullën 109(c) të Rregullores dhe afatit mbi dorëzimin e tabelës lidhur me të;

(2) Hetimet e ZPS-së dhe hapat e ardhshëm:

- c. Nëse mund të jepet një datë e përafërt për përfundimin e hetimeve të ZPS-së ende të papërfunduara;
- d. Vlerësimi i ZPS-së se kur do të jetë në gjendje të dorëzojë dosjen e vet paraprake dhe materialin në lidhje me të në pajtim me rregullën 95(4)(a)-(c) të Rregullores, në bazë të kalendarit për nxjerrjen e materialit të përcaktuar në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave;

(3) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e ardhshëm:

- e. Nëse, bazuar në vlerësimin e ZPS-së dhe të procesit në vijimësi të nxjerrjes së materialit (që është planifikuar të vazhdojë deri në korrik 2021), Mbrojtja mund të japë më shumë informacion mbi ecurinë e hetimeve të saj;
- f. Gjithashtu, nëse Mbrojtja, është në gjendje të japë më shumë informacion mbi çfarëdo synimi për të bërë kërkesa lidhur me mundësitë hetimore unike, në pajtim me rregullën 99(1) të Rregullores; dhe
- g. Nëse Mbrojtja është në gjendje të japë më shumë informacion për synimin për të dhënë njoftim për alibi ose arsye që përjashtojnë përgjegjësi penale, në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores dhe për nxjerrje të materialit përkatës në pajtim me rregullën 104(1) dhe (2) të Rregullores.

17. Së fundi, palëve do t'u kërkohet të japin mendimet e tyre lidhur me datën e konferencës së tretë mbi ecurinë e kësaj çështjeje.

18. Palët ftohen të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë të bëjnë një gjë të tillë, lidhur me temat më lart, ndër të cilat edhe temat e diskutuara gjatë konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, ose çfarëdo teme lidhur me procesin e nxjerrjes së materialit që nuk u mbulua në rendin e ditës së konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes, ose çfarëdo vështirësie lidhur me nxjerrjen e materialit provues. ZPS-ja ftohet të dorëzojë këto parashtrime deri të hënën, 14 dhjetor 2020, ora 16:00, dhe Mbrojtja ftohet të bëjë një gjë të tillë deri të martën, 15 dhjetor 2020, ora 16:00.

III. VENDIM

19. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** të thërrasë konferencën mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së dhe Mbrojtjes, **të enjten, 17 dhjetor 2020, në orën 11:00;**

- b. **KËRKON** nga ZPS-ja të dorëzojë parashtrime me shkrim, nëse dëshiron të bëjë një gjë të tillë, deri të **hënën, 14 dhjetor 2020, ora 16:00**, siç përcaktohet në paragrafin 18; dhe
- c. **KËRKON** nga Mbrojtja të dorëzojë parashtrime me shkrim, nëse dëshiron të bëjë një gjë të tillë, deri të **martën, 15 dhjetor 2020, ora 16:00**, siç përcaktohet në paragrafin 18.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 8 dhjetor 2020
Në Hagë, Holandë.